



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



**Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja
2026 - 2028**

Miratuar me Vendimin e Dekanatit
Nr. 08 datë 02.03.2026



I. Hyrje

Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë përbën një nga shtyllat kryesore për garantimin e standardeve akademike, zhvillimin profesional të stafit dhe përmirësimin e përvojës së studentëve. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, në përputhje me legjislacionin kombëtar për arsimin e lartë, standardet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), politikat e MAS për një arsim sa më cilësor dhe bashkëkohor dhe Standardet e Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë (ESG) synon ndërtimin dhe zbatimin e një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë. Kjo strategji përcakton vizionin, misionin, objektivat, mekanizmat dhe rezultatet e pritshme të Njësisë së Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

Strategjia e sigurimit të cilësisë është një dokument kryesor ku përcaktohen prioritetet parësore të arsimit të lartë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Misioni i tij është zhvillimi dhe rritja e cilësisë sipas standardeve të arsimit të lartë, ofrimit të programeve mësimore dhe aftësive të arritura në fushat akademike dhe shkencore të cilat janë në përputhje me tregun e punës. Rritja e cilësisë së shërbimit dhe përsosja e nivelit të mësimdhënies mbeten objektiva kryesore të fakultetit, të cilat realizohen përmes komunikimit të vazhdueshëm e konstruktiv me studentët. Paralelisht, fakulteti synon modernizimin e vazhdueshëm të infrastrukturës, duke përfshirë përmirësimin e laboratorëve, forcimin e kapaciteteve të bibliotekës dhe zgjerimin e proceseve të informatizimit, me qëllim krijimin e një mjedisi bashkëkohor që mbështet zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit. Nëpërmjet këtyre veprimeve të integruara, institucioni synon sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërinë e plotë me standardet e arsimit të lartë evropian.

Vizioni dhe Misioni

1. Vizioni

Të garantojë një kulturë të qëndrueshme të cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, duke promovuar ekselencën akademike, transparencën, përmirësimin e vazhdueshëm dhe përputhjen me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Misioni

Të monitorojë, vlerësojë dhe përmirësojë në mënyrë sistematike cilësinë e programeve të studimit, mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve mbështetëse, në funksion të zhvillimit akademik dhe profesional të studentëve dhe stafit.

II. Baza ligjore

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja harton Strategjinë për sigurimin e cilësisë bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij; Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë miratuar me vendim të KM- së; Statutin e Universitetit të Tiranës, Rregulloren "Për Sigurimin e Cilësisë në UT", Rregulloren për funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Manualin e Cilësisë, si dhe Paketën e Instrumenteve të Cilësisë, miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, me Vendimin nr. 51, datë 23.12.2020, Standardet dhe Udhëzimet për sigurimin e cilësisë në hapësirën Evropiane (ESG).



A. Strukturat përbërëse dhe implementuese të Strategjisë së cilësisë

1. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në njësinë kryesore, është ngritur nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me urdhër nr. 77, **datë 02.07.2021**. NJSBC është një strukturë ndihmësakademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e njësisë kryesore. Kjo njësi ka si mision të planifikojë, drejtojë, organizojë dhe të publikojë veprimtarinë e kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivelin e njësisë kryesore. NJSBC-ja luan një rol të rëndësishëm në krijimin e kulturës së cilësisë që ndikon të arrijë dhe ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe shërbyese të FGJH-së.

2. Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në njësitë bazë janë ngritur bazuar në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në UT”, me vendim nr. 14, **datë 20.07.2022**. NJSBC në njësinë bazë bashkëpunon me NJSBC-në e njësisë kryesore për vlerësimin e brendshëm të njësisë kryesore, dhe akreditimin institucional dhe të programeve. Në bashkëpunim me NJSBC-në e njësisë kryesore dhe zyrën e cilësisë dhe kurrikulave organizon vlerësimin studentor për cilësinë e mësimdhënies, në njësinë bazë, në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, si dhe përgatit raportin vjetor për sigurimin e cilësisë në nivelin e njësisë bazë.

B. Prioritetet e strategjisë së sigurimit të cilësisë :

1. Përmirësimi i kurrikulave dhe programeve të studimit:

Qëllimi: Përshtatja e programeve të studimit me zhvillimet shkencore, kërkesat e tregut të punës dhe standardet ndërkombëtare.

Veprime kryesore:

- Rishikimi dhe përditësimi i kurrikulave në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet e fundit shkencore.
- Integrimi i kompetencave praktike, digjitale dhe ndërkulturore në programet ekzistuese;
- Nxitja e hartimit të programeve ndërdepartamentale dhe ndërfakultetore;
- Promovimi i ndërkombëtarizimit përmes programeve të përbashkëta dhe/ose të dyfishta.

Rezultate të pritshme: Programe studimi konkurruese, fleksibile dhe të orientuara drejt punësimit.

2. Standardizimi i metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit:

Qëllimi: Garantimi i një procesi mësimor cilësor, transparent dhe objektiv.

Veprime kryesore:



- Trajnime për stafin akademik mbi metodologjitë moderne, interaktive dhe me në qendër studentin;
- Përdorimi i metodave të qarta dhe të drejta të vlerësimit të studentëve;
- Standardizimi i kriterëve dhe instrumenteve të vlerësimit për të reduktuar subjektivitetin;
- Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të këtyre standardeve.

Rezultate të pritshme: Rritje e cilësisë së mësimdhënies dhe besueshmërisë së procesit të vlerësimit.

3. Kualifikimi dhe zhvillimi profesional i stafit akademik:

Qëllimi: Forcimi i kapaciteteve pedagogjike, kërkimore dhe profesionale të stafit.

Veprime kryesore:

- Formim i vazhdueshëm akademik dhe profesional përmes trajnimeve, projekteve kërkimore dhe leksioneve të hapura;
- Nxitja e pjesëmarrjes në mobilitete akademike dhe aktivitete ndërkombëtare;
- Mbështetje institucionale për avancimin shkencor dhe pedagogjik.

Rezultate të pritshme: Staf akademik më i kualifikuar, inovativ dhe i përfshirë ndërkombëtarisht.

4. Përmirësimi i infrastrukturës dhe burimeve akademike:

Qëllimi: Krijimi i një mjedisi bashkëkohor për mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Veprime kryesore:

- Modernizimi i mëtejshëm i laboratorëve dhe mjediseve mësimore;
- Pasurimi i bibliotekave fizike dhe digjitale;
- Implementimi i platformave digjitale për mësimdhënie, vlerësim dhe kërkim.

Rezultate të pritshme: Rritje e aksesit në burime cilësore dhe përmirësim i përvojës akademike.

5. Sistemet efektive të vlerësimit dhe akreditimit:

Qëllimi: Garantimi i cilësisë së programeve përmes monitorimit sistematik dhe vlerësimit të vazhdueshëm.

Veprime kryesore:

- Standardizimi i parametrave të cilësisë;
- Zhvillimi i mekanizmave për monitorimin e programeve akademike;
- Përgatitje e vazhdueshme për procese akreditimi të brendshme dhe të jashtme.

Rezultate të pritshme: Përputhje e plotë me standardet kombëtare dhe evropiane të cilësisë.



6. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit:

Qëllimi: Rritja e dimensionit ndërkombëtar të fakultetit.

Veprime kryesore:

- Zgjerimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për shkëmbime studentore dhe akademike;
- Hartimi dhe zbatimi i programeve me diploma të përbashkëta ose të dyfishta;
- Përdorimi i gjuhëve të huaja në ofrimin e programeve të studimit.

Rezultate të pritshme: Rritje e mobilitetit, reputacionit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

7. Përfshirja e studentëve në proceset e sigurimit të cilësisë:

Qëllimi: Fuqizimi i rolit të studentëve si partnerë aktivë në sigurimin e cilësisë.

Veprime kryesore:

- Mbledhje sistematike e feedback-ut të studentëve;
- Përfshirja e përfaqësuesve të studentëve në struktura vendimmarrëse;
- Informimi i studentëve mbi rezultatet e vlerësimeve dhe masat përmirësuese.

Rezultate të pritshme: Rritje e kënaqësisë dhe angazhimit të studentëve.

8. Promovimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit:

Qëllimi: Zhvillimi i një kulture kërkimore aktive dhe inovative.

Veprime kryesore:

- Mbështetje për projekte kërkimore konkurruese;
- Nxitja dhe mbështetja e grupeve mësimore-kërkimore;
- Mbështetje institucionale për publikime shkencore dhe konferenca, mobilitete dhe aktivitete kërkimore shkencore.

Rezultate të pritshme: Rritje e produkteve shkencore dhe impaktit akademik.

9. Mobiliteti stafit dhe studentëve:

Qëllimi: Rritja e shkëmbimeve akademike dhe përvojave ndërkombëtare.

Veprime kryesore:

- Informim dhe nxitje e vazhdueshme për mobilitete Erasmus+ dhe programe të tjera;
- Mbështetje administrative për aplikimet dhe njohjen e krediteve;
- Monitorimi i ndikimit të mobilitetit në cilësinë akademike.



Rezultate të pritshme: Staf dhe studentë më të ekspozuar ndaj praktikave ndërkombëtare dhe standardeve evropiane.

Prioritetet e mësipërme janë thelbësore për të garantuar një sistem universitar të qëndrueshëm, të përqendruar te studentët dhe i aftë të përgatisë profesionistë të suksesshëm në tregun global.

C. Parimet për menaxhimin e cilësisë

Sistemi i menaxhimit të cilësisë në FGJH ndërtohet dhe funksionon mbi një sërë parimesh themelore, të cilat udhëheqin të gjitha proceset akademike, kërkimore dhe administrative të institucionit. Këto parime sigurojnë koherencë midis misionit, objektivave strategjike dhe veprimtarisë së përditshme, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësi të vazhdueshme.

1. **Studenti në fokus.** Ky parim bazohet në vendosjen e studentit në qendër të të gjitha proceseve institucionale. Ai nënkupton përmbushjen me cilësi të nevojave akademike, sociale dhe profesionale të studentëve, si dhe sigurimin e infrastrukturës fizike, digjitale dhe mbështetëse të nevojshme për një proces mësimor efektiv. FGJH angazhohet për përgatitjen cilësore të studentëve në fushat e studimit që ndjekin, për garantimin e programeve të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e shoqërisë shqiptare, si dhe për sigurimin e vlefshmërisë, njohjes dhe konkurrueshmërisë së diplomës së përfutur në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

➤ Indikatorë matës (KPI)

- Niveli i kënaqësisë së studentëve (anketa vjetore)
- Shkalla e përfundimit të studimeve në kohë (%)
- Norma e punësimit të të diplomuarve brenda 3 – 5 vite studimi (%)
- Raporti student/staf akademik
- Numri i shërbimeve mbështetëse për studentët (karrierë, këshillim, tutorim)

➤ Në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe legjislacionin e ASCAL

- Përfshirja aktive e studentëve dhe të nxëniet me studentin në qendër - Standardi III.15
- Pranimi, përparimi, njohjet dhe diplomimi - Standardet V.1 / V.2
- Transparenca e informimit publik - Standardi I.6 / II.14

2. **Lidershipi.** Parimi i lidërshipt nënkupton drejtimin strategjik dhe të qëndrueshëm të institucionit në funksion të sigurimit të cilësisë. Orientimi i veprimtarisë së FGJH-së sipas një vizioni të qartë, misioni të përcaktuar dhe objektivash afatshkurtër e afatgjatë krijojnë kushtet për ndërtimin dhe funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Lidërshipi institucional luan rol kyç në krijimin e një kulture cilësie, në mobilizimin e burimeve njerëzore dhe materiale, si dhe në mbështetjen e iniciativave për përmirësim të vazhdueshëm.



➤ **Indikatorë matës (KPI)**

- Ekzistenca dhe zbatimi i strategjisë institucionale
- Numri i vendimeve strategjike të bazuara në raporte cilësie
- Frekuenca e rishikimit të planeve strategjike
- Përfshirja e drejtuesve në aktivitetet e sigurimit të cilësisë

➤ **Në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe legjislacionin e ASCAL**

- Qeverisje, strategji dhe efikasitet menaxherial - Standardet I.1–I.5
- Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë (SBC) - Standardi I.7
- Cikli i vlerësimit të jashtëm/akreditimi - Standardi I.7

3. **Përfshirja e personelit.** Ky parim nënvizon rëndësinë e përfshirjes aktive të të gjithë anëtarëve të komunitetit akademik dhe administrativ në proceset e sigurimit të cilësisë. Respektimi i kontributit individual dhe kolektiv të personelit nxit ndjenjën e përgjegjësisë, bashkëpunimit dhe angazhimit profesional. Përmes përfshirjes së gjerë, secili anëtar kontribuon në përmbushjen e objektivave të cilësisë, ndërkohë që krijohet një mjedis pune që promovon transparencën, llogaridhënien dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm.

➤ **Indikatorë matës (KPI)**

- Pjesëmarrja e stafit në trajnime profesionale (%)
- Numri i aktiviteteve të zhvillimit profesional në vit
- Përfshirja e stafit në grupe pune dhe komisione cilësie
- Rezultatet e anketave të kënaqësisë së stafit

➤ **Në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe legjislacionin e ASCAL**

- Politikat e burimeve njerëzore - Standardet II.1–II.6
- Vlerësimi i performancës akademike - Standardi III.10

4. **Qasja e procesit.** Qasja e procesit konsiston në identifikimin, ndërlikjen dhe menaxhimin e të gjitha veprimtarive të FGJH-së si procese të integruara brenda një sistemi funksional. Funksionimi i institucionit si një tërësi e harmonizuar ndihmon në optimizimin e burimeve, rritjen e efikasitetit dhe arritjen e rezultateve të qëndrueshme. Kjo qasje mundëson monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të proceseve akademike dhe administrative, duke krijuar bazë të fortë për përmirësime të planifikuara.

➤ **Indikatorë matës (KPI)**

- Numri i proceseve të dokumentuara dhe të standardizuara
- Koha mesatare e përfundimit të proceseve administrative
- Rezultatet e auditimeve të brendshme të cilësisë



- Shkalla e përmbushjes së objektivave të proceseve (%)

➤ **Në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe legjislacionin e ASCAL**

- Monitorim dhe rishikim i vazhdueshëm i programeve - Standardi I.8
- Vlerësimi i brendshëm periodik - Standardi I.9
- Sistemet e të dhënave dhe IT - Standardet II.13–II.15

5. **Përmirësimi.** Përmirësimi i vazhdueshëm është një element thelbësor për ruajtjen dhe rritjen e cilësisë në një mjedis arsimor që karakterizohet nga ndryshime të shpejta dhe kërkesa në rritje. FGJH e konsideron përmirësimin jo si një veprim sporadik, por si një proces të pandërprerë që synon ruajtjen e nivelit të arritur të performancës, reagimin ndaj ndryshimeve të jashtme dhe krijimin e mundësive të reja zhvillimi. Ky parim mbështet inovacionin në mësimdhënie, kërkim dhe administrim, duke çuar në rritjen e standardeve të cilësisë.

➤ **Indikatorë matës (KPI)**

- Numri i masave përmirësuese të zbatuara në vit
- Përqindja e rekomandimeve të realizuara nga vlerësimet
- Evolucionin e rezultateve të indikatorëve kryesorë
- Numri i risive në mësimdhënie dhe kërkim

➤ **Në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe legjislacionin e ASCAL**

- Cikli i përmirësimit të programeve - Standardet III.10 / III.11
- Transparencë dhe plane masash - Standardi I.11

6. **Vendimmarrja e bazuar në evidencë.** Vendimmarrja institucionale mbështetet në analiza të sakta, të dhëna të besueshme dhe evidenca të verifikueshme. Ky parim siguron objektivitet në procesin e vendimmarrjes dhe ndihmon në marrjen e vendimeve të informuara që prodhojnë rezultate të matshme dhe të qëndrueshme. Përdorimi sistematik i të dhënave statistikore, raporteve të vlerësimit dhe feedback-ut të palëve të interesuara forcon transparencën dhe efikasitetin e menaxhimit të cilësisë.

➤ **Indikatorë matës (KPI)**

- Përdorimi i raporteve statistikore në vendimmarrje
- Frekuenca e mbledhjes dhe analizës së të dhënave
- Ekzistenca e databazave institucionale të përditësuara
- Numri i vendimeve të dokumentuara me evidencë

➤ **Në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe legjislacionin e ASCAL**



- Dokumentacion, statistika dhe sisteme - Standardet II.13 / II.14 / V.4
- Informim publik - Standardi I.6

7. **Menaxhimi i marrëdhënieve.** FGJH njeh rëndësinë e palëve të interesuara (studentë, staf akademik dhe administrativ, punëdhënës, institucione partnere, komuniteti dhe shoqëria në tërësi) në ndikimin që ato kanë mbi performancën institucionale.

Menaxhimi efektiv i marrëdhënieve me këto palë synon ndërtimin e bashkëpunimeve të qëndrueshme dhe optimizimin e ndikimit të tyre në zhvillimin e institucionit. Suksesi afatgjatë arrihet përmes dialogut të vazhdueshëm, bashkëpunimit dhe integritetit të pritshmërive të palëve të interesuara në proceset e sigurimit të cilësisë.

➤ **Indikatorë matës (KPI)**

- Numri i marrëveshjeve aktive me partnerë
- Pjesëmarrja e punëdhënësve në rishikimin e programeve
- Feedback-u i palëve të interesuara (anketa, takime)
- Aktivitetet e përbashkëta me komunitetin dhe biznesin

➤ **Në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe legjislacionin e ASCAL**

- Bashkëpunime dhe partneritete - Standardet II.19–II.21 / II.20 / II.22
- Alumni - Standardi V.9

D. Fushat e veprimtarive në kuadër të sigurimit të cilësisë

Sigurimi i brendshëm i cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja mbështetet në Rregulloren e Cilësisë së UT-së, Statutin e institucionit dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Ky proces përqendrohet në vlerësimin sistematik, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë akademike dhe administrative. Fushat kryesore të veprimtarisë në kuadër të sigurimit të cilësisë janë si më poshtë:

1. Veprimtaria tërësore e institucionit

Kjo fushë përfshin vlerësimin e funksionimit të përgjithshëm të fakultetit në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat strategjike të institucionit. Analizohet efektiviteti i strukturave drejtuese, zbatimi i politikave të brendshme, transparenca në vendimmarrje dhe koherenca midis strategjisë institucionale dhe praktikave të përditshme.

2. Programet e studimit dhe procesi i mësimdhënies

Në këtë fushë vlerësohet cilësia e programeve të studimit, përmbajtja e kurrikulave, rezultatet e të nxënësve dhe përputhja e tyre me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu monitorohet procesi i mësimdhënies, përdorimi i metodologjive bashkëkohore, ngarkesa akademike dhe efektiviteti i metodave të vlerësimit të studentëve.

3. Kërkimi shkencor dhe veprimtaria kërkimore



Kjo fushë fokusohet në vlerësimin e aktivitetit kërkimor të stafit akademik dhe njësive përkatëse. Analizohen projektet kërkimore, publikimet shkencore, pjesëmarrja në konferenca, bashkëpunimet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ndikimi i kërkimit në zhvillimin akademik dhe shoqëror.

4. Arritjet dhe progresi akademik i studentëve

Vlerësohen rezultatet akademike të studentëve, shkalla e përfundimit të studimeve, koha mesatare e diplomimit, punësueshmëria pas diplomimit dhe pjesëmarrja në mobilitete akademike. Kjo fushë synon të evidentojë nivelin e arritjes së kompetencave dhe efektivitetin e programeve të studimit.

5. Shërbimet për studentët dhe mbështetja akademike

Kjo fushë përfshin cilësinë dhe aksesin në shërbimet që u ofrohen studentëve, si këshillimi akademik, shërbimet administrative, bibliotekat, infrastruktura digjitale dhe mbështetja për studentët me nevoja të veçanta. Vlerësohet ndikimi i këtyre shërbimeve në përmirësimin e përvojës studentore.

6. Performanca dhe zhvillimi i personelit

Në këtë fushë analizohet performanca e stafit akademik dhe administrativ, kualifikimi profesional, angazhimi në mësimdhënie, kërkim dhe shërbime institucionale. Gjithashtu vlerësohen politikat e zhvillimit profesional, trajnimit të vazhdueshëm dhe sistemi i vlerësimit të performancës.

Këto fusha përbëjnë bazën e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe shërbejnë si instrumente kryesore për identifikimin e problematikave, marrjen e masave përmirësuese dhe garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

❖ Objektivat

✓ Objektivi 1. Konsolidimi dhe zhvillimi i sistemit të sigurimit të cilësisë dhe zbatimi efektiv i akteve rregullatore

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka tashmë një sistem siguri të cilësisë relativisht të ri, i cili është angazhuar plotësisht në krijimin e të gjitha akteve rregullatore, si Rregullore, Strategji, plan veprimi, si dhe për zhvillimin e saj në të gjitha fushat përgjatë vitit të fundit. Ky fakt u ofron të gjithë aktorëve mundësinë për të përmirësuar vazhdimisht aktivitetet e tyre në të gjitha fushat e kërkimit dhe transferimit të njohurive.

➤ Veprimet që do të kryhen:

1.1. Promovimi sistematik i kulturës së sigurimit të cilësisë përmes aktiviteteve informuese dhe sensibilizuese për studentët, stafin akademik dhe administrativ.

1.2. Monitorimi periodik dhe vlerësimi i përmbushjes së standardeve akademike të programeve të studimit, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ESG.

1.3. Rishikimi, përmirësimi dhe standardizimi i instrumenteve të vlerësimit (pyetësorëve) për:

- studentët
- stafin akademik



- stafin administrativ
- doktorantët
- alumni

1.4. Hartimi dhe zbatimi i planeve të veprimit bazuar në rezultatet e monitorimit, me qëllim përmirësimin, zhvillimin dhe adresimin e problematikave të identifikuara.

1.5. Rishikimi periodik i rregulloreve dhe dokumenteve strategjike të sigurimit të cilësisë.

➤ **Rezultate të pritshme:**

1.1. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit mbi sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet e fakultetit.

1.2. Përditësimi dhe harmonizimi i planit të veprimit të sigurimit të cilësisë.

1.3. Përmirësimi i rregullores së sigurimit të cilësisë.

1.4. Rishikimi i programeve dhe planeve mësimore në përputhje me standardet akademike dhe tregun e punës.

1.5. Përditësimi i syllabuseve dhe harmonizimi i tyre me rezultatet e të nxënit.

1.6. Identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta të programeve ekzistuese.

1.7. Koordinimi i procesit të vetëvlerësimit të brendshëm dhe përgatitja për akreditimin e jashtëm.

➤ **KPI – Indikatorë të performancës**

- % e dokumenteve rregullatore të përditësuara (rregullore, strategji, plane veprimi)
- Numri i aktiviteteve informuese mbi sigurimin e cilësisë në vit
- % e programeve të studimit të monitoruara sipas standardeve
- Numri i programeve/planeve mësimore të rishikuara
- Numri i raporteve vjetore të sigurimit të cilësisë të hartuara dhe miratuara

➤ **Plan Veprimi 2-Vjeçar – Objektivi 1**

Veprimi	Afati	Përgjegjës	Burime
Promovimi i kulturës së sigurimit të cilësisë	Viti 1–2 (çdo semestër)	NJSBC, Dekanati, Njësitë Bazë	Burime njerëzore, materiale informative, platforma digjital
Monitorimi i standardeve të programeve të studimit	Viti 1 (analizë), Viti 2 (rishikim)	NJSBC, GVB, Koordinatorë programesh	Raporte, dokumentacion akademik, pyetësorë
Rishikimi i pyetësorëve për studentë, staf, doktorantë, alumni	Viti 1	NJSBC, ekspertë metodologjie	Platformë pyetësorësh, ekspertizë statistike



✓ **Objektivi 2. Rritja e gjithëpërfshirjes dhe ndërgjegjësimit të aktorëve në proceset e sigurimit të cilësisë**

Sigurimi i cilësisë është një proces kolektiv dhe gjithëpërfshirës që kërkon angazhimin aktiv të të gjitha palëve të interesuara. Fakulteti synon forcimin e pjesëmarrjes së drejtuesve, stafit akademik, administrativ, studentëve dhe aktorëve të jashtëm në ciklin e vazhdueshëm të monitorimit dhe përmirësimit.

➤ **Veprimet që do të kryhen:**

- 2.1. Përfshirja aktive dhe informimi i vazhdueshëm i pedagogëve dhe studentëve mbi rolin e tyre në sigurimin e cilësisë.
- 2.2. Trajnimi i përfaqësuesve të NJSBC mbi metodologjitë e monitorimit, analizës së të dhënave dhe hartimit të raporteve cilësore.
- 2.3. Organizimi i takimeve periodike ndërmjet përfaqësuesve të NJSBC, stafit dhe studentëve për diskutimin e rezultateve dhe problematikave.
- 2.4. Mbështetja dhe trajnimi i grupeve të vlerësimit të brendshëm (GVB) sipas nevojave të identifikuara.

➤ **Rezultate të pritshme:**

- 2.1. Ndërgjegjësim më i lartë i pedagogëve dhe studentëve mbi proceset e sigurimit të cilësisë.
- 2.2. Rritja e pjesëmarrjes në plotësimin e pyetësorëve të vlerësimit.
- 2.3. Koordinim më efikas i procesit të vlerësimit të brendshëm.
- 2.4. Hartimi dhe zbatimi i planeve të masave nga njësitë bazë për adresimin e problematikave.

➤ **KPI – Indikatorë të performancës**

- % e stafit akademik të përfshirë në proceset e sigurimit të cilësisë
- % e studentëve që plotësojnë pyetësorët
- Numri i trajnimeve të realizuara për NJSBC dhe GVB
- Numri i takimeve periodike me studentët dhe stafin
- Numri i planeve të masave të hartuara nga njësitë bazë

➤ **Plan Veprimi 2-Vjeçar – Objektivi 2**

Veprimi	Afati	Përgjegjës	Burime
Informimi dhe përfshirja aktive e pedagogëve dhe studentëve	Viti 1–2	NJSBC, Njësitë Bazë	Salla, materiale prezantimi, platforma online
Trajnimi i përfaqësuesve të NJSBC dhe GVB	Viti 1	NJSBC, Drejtoria e Kurrikulave dhe i Cilësisë (UT)	Trajnerë, manuale, udhëzues ESG



Takime periodike për diskutimin e rezultateve	Çdo vit akademik	NJSBC, drejtues njësisish	Raporte pyetësorësh, analiza
---	------------------	---------------------------	------------------------------

✓ **Objektivi 3. Identifikimi sistematik i nevojave dhe problematikave institucionale**

Sigurimi i cilësisë bazohet në një cikël të vazhdueshëm monitorimi, vlerësimi, ndërhyrjeje dhe rishikimi. Ky proces mundëson identifikimin e nevojave reale të institucionit dhe përmirësimin e performancës akademike dhe administrative.

➤ **Veprimet që do të kryhen:**

- 3.1. Organizimi i vlerësimit studentor për cilësinë e mësimdhënies.
- 3.2. Plotësimi dhe analiza e formularëve përmbledhës të veprimtarisë së pedagogëve.
- 3.3. Vlerësimi i studentëve që diplomohen dhe analiza e rezultateve të tyre.
- 3.4. Vlerësimi institucional nga stafi akademik, ndihmësakademik dhe administrativ.
- 3.5. Analiza krahasuese e rezultateve ndër vite.

➤ **Rezultate të pritshme:**

- 2.1. Nxjerrja e rezultateve të detajuara nga pyetësorët e vlerësimit.
- 2.2. Identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta të veprimtarisë institucionale.
- 2.3. Hartimi i planeve ndërhyrëse për përmirësimin e cilësisë.

KPI – Indikatorë të performancës

- Numri i vlerësimeve studentore të realizuara
- % e formularëve të plotësuar nga stafi akademik
- Numri i raporteve analitike të përgatitura
- Numri i planeve ndërhyrëse të hartuara
- Përmirësim i treguesve ndër vite (krahasim vjetor)

➤ **Plan Veprimi 2-Vjeçar – Objektivi 3**

Veprimi	Afati	Përgjegjës	Burime
Vlerësimi studentor i cilësisë së mësimdhënies	Çdo semestër	NJSBC, Njësitë Bazë	Pyetësorë online, platforma digjitale
Analiza e formularëve të veprimtarisë së pedagogut	Viti 1–2	NJSBC, drejtues departamentesh	Formulare standarde, databazë
Vlerësimi i institucionit nga stafi	Viti 2	NJSBC	Pyetësorë, analiza krahasuese



✓ **Objektivi 4. Analiza e rezultateve të matshme dhe formulimi i rekomandimeve për përmirësim të vazhdueshëm**

Zhvillimi i qëndrueshëm i sistemit të sigurimit të cilësisë mbështetet në analizën e rezultateve të vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme dhe në zbatimin e rekomandimeve konkrete për përmirësim.

➤ **Veprimet që do të kryhen:**

- 4.1. Përcjellja e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit tek strukturat përkatëse.
- 4.2. Analizimi i të dhënave dhe problematikave të identifikuara nga pyetësorët dhe raportet e vlerësimit.
- 4.3. Formulimi i rekomandimeve konkrete dhe të matshme për përmirësim.
- 4.4. Monitorimi i zbatimit dhe efektivitetit të masave përmirësuese.

➤ **Rezultate të pritshme:**

- 4.1. Vendimmarrje e bazuar në evidencë.
- 4.2. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë akademike dhe institucionale.
- 4.3. Përgatitje më e strukturuar për vlerësimet e jashtme dhe akreditimin.

KPI – Indikatorë të performancës

- Numri i raporteve analitike të hartuara
- % e rekomandimeve të zbatuara
- Numri i masave përmirësuese të monitoruara
- Evidencë e përmirësimit të treguesve cilësorë
- Gatishmëri për vlerësim të jashtëm / akreditim

➤ **Plan Veprimi 2-Vjeçar – Objektivi 4**

Veprimi	Afati	Përgjegjës	Burime
Analiza e rezultateve të pyetësorëve dhe raporteve	Çdo vit	NJSBC	Të dhëna statistikore, softuer analize
Formulimi dhe zbatimi i rekomandimeve	Viti 2	Dekanati, Njësitë Bazë	Plane masash, burime njerëzore
Monitorimi i efektivitetit të masave	Viti 2 (pas zbatimit)	NJSBC	Raporte ndjekjeje, evidenca

Përfundime:



Analiza e përgjithshme e sistemit të sigurimit të cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja evidenton ekzistencën e një kuadri funksional dhe në zhvillim të vazhdueshëm, i ndërtuar mbi parime bashkëkohore të menaxhimit të cilësisë dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të akreditimit. Sistemi i sigurimit të cilësisë është konsoliduar si një mekanizëm thelbësor për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve akademike, kërkimore dhe administrative.

Vendosja e studentit në qendër të procesit arsimor, përfshirja aktive e stafit akademik dhe administrativ, si dhe ndërtimi i vendimmarrjes mbi bazën e evidencës, përbëjnë shtyllat kryesore të funksionimit të këtij sistemi. Përmes përdorimit të instrumenteve të standardizuara të vlerësimit, analizës sistematike të të dhënave dhe përfshirjes së palëve të interesuara, Fakulteti ka krijuar kushtet për identifikimin e qartë të pikave të forta dhe atyre që kërkojnë përmirësim.

Integrimi i objektivave strategjike me indikatorë konkretë të performancës (KPI) dhe burime të qarta prove ka mundësuar ndërtimin e një sistemi të gjurmueshëm, transparent dhe të matshëm, i cili mbështet procesin e përmirësimit të vazhdueshëm. Ky integrim siguron që çdo objektiv të shoqërohet me veprime konkrete, afate të përcaktuara, përgjegjësi institucionale dhe evidenca të verifikueshme, duke forcuar besueshmërinë e sistemit të cilësisë.

Plani i Veprimit 2-vjeçar përfaqëson një instrument operacional të rëndësishëm, i cili lidh strategjinë me zbatimin praktik. Ai krijon një strukturë të qartë për ndjekjen e progresit, monitorimin e rezultateve dhe rishikimin periodik të masave të ndërmarra, në përputhje me ciklin PBKV (Planifiko–Bëj–Kontrollo – Vepron). Ky plan kontribuon në rritjen e efikasitetit të menaxhimit akademik dhe në përmirësimin e qëndrueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve mbështetëse.

Objektivat, KPI dhe rezultatet e pritshme përbëjnë një element kyç për dosjen e akreditimit, pasi ofrojnë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar të përputhshmërisë së veprimtarisë së Fakultetit me standardet e ASCAL. Kjo dëshmon aftësinë institucionale për të mbledhur, analizuar dhe përdorur evidencën në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe përgatitjes për vlerësime të jashtme.

Në përfundim, materiali i hartuar dëshmon se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka ndërtuar dhe po zhvillon një sistem të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë, të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm, transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale. Ky sistem përbën një bazë solide për zhvillimin e mëtejshëm akademik, rritjen e besueshmërisë së programeve të studimit dhe përmbushjen me sukses të kërkesave të akreditimit institucional dhe programor.

Miratoi

DEKAN

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

